



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim për korrupsion, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-1369 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit nr. 12-1369/1 me datë 12.03.2019 dorëzuar nga parashtrues panjohur, **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën 12-1369 nga viti 2019, në rastin e lëndës zhvilloher procedurë para organi tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-1369 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-1369 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit me nr. 12-1369/1 me datë 12.03.2019, dorëzuar deri te Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtrues i panjohur (denoncim anonim).

Në denoncimin e dorëzuar parashtrusi i thekson dias akuza kundër rektorit dhe funksionarë tjerë të lartë në Universitetin Shtetëror në, dhe atë: akuza për keqpërdorime finansiare të Buxhetit në Universitetin e përmendur, në lidhje me lartësinë e shpenzimeve që i pagujnë studentët, gjegjësisht në lidhje me caktimin e lartësisë së kofinansimit, participimit, caktimi i kontributit për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë dhe të tretë dhe shpenzime tjera të studentëve në institucioni e lartë arsimor të përmendur, si dhe për mënyrën e përdorimit të tyre, gjegjësisht shpërndarja e mjeteve të fituara në këtë fomrë; akuza për nepotizëm në procedurat për punësim në kohë të pacaktuar dhe angazhim honorar të farefisnisë dhe të afërme në bazë failjarëve nga rektori dhe funksionarë tjerë dhe akuza për dhënje të tenderit në vlerë prej 85.000 euro në mënyrë fiktive, për furnizim të shërbime informatike për evidencë shumëgjuhsore të proceseve të punës në Universitetin Shtetëror në

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendje faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Prokuroria themelore publike dhe Inspektoratin shtetëror të arsimit, për veprim kompetent dhe për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës së KSHPK janë dorëzuar informimet e kërkuara dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilin disponon për rastin e lëndës KSHPK e caktori gjendjen faktike vijuese:

- Në lidhje me akuzat për keqpërdorime finansiare, KSHPK kërkoi nga Inspektorati shtetëror i arsimit të vepron në përputhje me kompetencat e veta ligjore për kryerje të mbikqyrje mbi zbatimin e rregullativës ligjore në institucionin e lartë arsimor-shkencor dhe të bënë inspektim të jashtëzakonshëm mbi punën e Universitetit Shtetëror në për periudhën prej viti 2018 deri 2019, me theks të veçant në akuzat e lëndës.
- Në lidhje me akuzat për nepotizëm në procedurën e punësimeve të realizuara në Univeristetin e lëndës, është konstatuar se për këto dhe akuza të ngjashme në KSHPK vetëmse po veprohet për lëndë të formuara nga Njësia për parandalim të konfliktit të interesave.
- Në lidhje me akuzat për kontraktim të tenderit në vlerë prej 85.000 euro në mënyrë fiktive, nëpërmjet shpallje publike për procedurën për furnizime publike nr. .../2015 për furnizim me Shërbime informatike për evidenë shumëgjuhsore në Universitetin Shtetëror në, KSHPK gjatë kontrollimit të bërë në portalet në internet dhe shpalljet në medime erdhi në njohuri se për rastin e lëndë është ngritur kallëzim penal, pra në lidhje me të njëjtë është kërkuar informacion nga Prokuroria themelore publike për atë se a është vepruar dhe si është vepruar nga ana e tyre në lidhje me kallëzimin penal të dorëzuar nga Drejtoria për polici finansiare.
- Me datë 24.07.2020, me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërim nga Prokuroria themelore publike me të cilën lajmërohet se në lidhje me rastin e lëndës me datë 15.11.2019 Drejtoria për polici finansiare – Shkup deri tek Prokuroria themelore publike dorëzoi kallëzim penal kundër personave në cilësi të Udhëheqësit të Qendrës për teknologji informatike pranë Universitetit Shtetëror në, në cilësi të Këshilltarit për TIK (teknologji informatike dhe kompjuterike) pranë Universitetit Shtetëror në dhe, në cilësi të Bashkëpunorit për TIK (teknologji informatike dhe kompjuterike) pranë Universitetit Shtetëror në për arsye të ekzistimit të dyshimit për vepër të kryer penale Punë të pamenduar mirë në detyrë nga neni 353-v paragrafi 3 nga Kodi penal. Në Prokurorinë themelore publike të lëndës pas dorëzimit të denoncimit është formuar lëndë për të cilën po veprohet dhe lënda është në fazë të mbledhjes për proceseve vepruese, por për shkak të pandemisë me virusin korona COVID-19, disa procese vepruese janë reorientuar për ditë tjera, kurse procedura për lëndën do të vazhdonte. Në shtesë të lajmërimit është dorëzuar kallëzimi penal.
- Me datë 17.08.2020 me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërim nga Inspektorati shtetëror i arsimit me të cilin informojnë se nga ana e tyre nuk mund të bëjnë inspektim të jashtëzakonshëm në lidhje me punën finansiare dhe keqpërdorimet finansiare në Universitetin Shtetëror në, me arsye se nuk është në kompetencë të Inspektoratit shtetëror të arsimit. KSHPK informohet se fitimi i mjeteve finansiare dhe shpërndarja e të njëjtave në institucionin e lartë arsimor, gjegjësisht harxhimi i të njëjtave ka qenë në mënyrë të rregullt sipas akteve të tyre të brendshme, të miratuara nga trupat dhe organet e institucionit të lartë arsimor, si dhe me aktet e Ministrië së arsimit dhe shkencës, për të cilën kontrollë është bërë nga ana e revizionit të brendshëm të institucionit të lartë arsimor, gjegjësisht kësi kontrollime finansiare ka bërë edhe Ministria e arsimit dhe shkencës dhe Enti shtetëror për revizion.

Në bazë të gjendjes faktike të caktuar më sipër, KSHPK konstaton se në lidhje me akuzat në denoncimin e dorëzuar për keqpërdorime finansiare dhe për nepotizëm në procedurën për punësim është vepruar nga ana e organeve tjera kompetente, dhe njëherit në lidhje me akuzat në denoncim për kontraktim të tenderit në mënyrë fiktive në procedurën për furnizime publike për shërbime informatike për evidencë shumëgjusore të proceseve punuese në universitetin e lëndës, është dorëzuar kallëzim penal për të cilin është formuar lëndë për të cilën vepron Prokuroria themelore publike e cila ka ndërmarrë veprime të veta kompetente dhe pran së cilës procedura për lëndën ende është në rrjedhë. Duke pas parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke marrë parasyshë të gjithë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

Është vendosur me datë 29 dhjetor të vitit 2020, me numër 12-2489/5

Dorëzuar deri tek: Arkiva
Pas përfundimit të KSHPK
Punoi: J. C., Këshilltarë
Miratoi: m-r V. G., Anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHТETӨRӨRӨ ПӨR
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska